



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË		UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI		
r. / Br. / No. 487	Nr. i ftoq/ Br. str / No. pg 8	
Datim / Date: 10/03/2021 Pejë / Peë		

SENATI

Nr. 29.02.2021

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SENATIT TË UNIVERSITETIT

Pejë, 2021

Në bazë të nenit 46 pika 1 dhe të nenit 48 pika 1.23 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka"-Pejë, Senati i këtij Universiteti, në mbledhjen e mbajtur më 29.02.2021 miratoi këtë:

RREGULLORE PËR ORGANIZIMIN DHE PUNËN E SENATIT TË UNIVERSITETIT

Dispozitat e përgjithshme

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet organizimi dhe mënyra e punës së Senatit të Universitetit "Haxhi Zeka" si: konvokimi i mbledhjes, kryesimi, mbajtja, procedura e zgjedhjes, mënyra e marrjes së vendimeve, zbatimi i vendimeve dhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën e Senatit.

U. Verifikimi i mandatit të anëtarëve të Senatit

Neni 2

Mbledhjen konstituive dhe mbledhjet tjera të Senatit, i thërret rektori aktual i Universitetit dhe i kryeson ato derisa të zgjedhet kryesuesi i përkohshëm i Senatit.

Neni 3

- 1) Në mbledhjen e parë, Senati i verifikon mandatet e anëtarëve të Senatit në bazë të raportit të Sekretarit të Përgjithshëm në lidhje me rregullsinë e zgjedhjeve të anëtarëve të Senatit nga njësitë akademike, me propozim për verifikimin e mandatit,
- 2) Votimi për raportin bëhet në tërësi, nëse nuk është kontestuar asnjë mandat. Në rast se ndonjë mandat është kontestuar, së pari votohet për të gjitha mandatet e pakontestueshme, e pastaj për çdo mandat të kontestueshëm votohet në mënyrë të veçantë,
- 3) Nëse Senati konstaton se zgjidhja është bërë në mënyrë jo të rregullt, Senati do të kërkojë nga njësitë akademike që zgjedhjet e kontestuara të përsëriten.
- 4) Anëtari i Senatit, të cilit i është kontestuar ose i është shtyrë vendimi për verifikimin e mandatit, ka të drejtë të vazhdojë pjesëmarrjen në mbledhje, por pa të drejtë vote.

Neni 4

Pas verifikimit të mandatit, anëtarët e Senatit e nënshkruajnë deklaratën etike si vijon:
"Unë, (Emri dhe mbiemri) deklaroj se do t'i kryej detyrat me nder dhe besnikëri, me drejtësi dhe pa anim, me ndërgjegje dhe përgjegjësi, dhe do t'i përfaqësoj me paanshmëri dhe përkushtim interesat e Universitetit dhe do t'i përmbahem Statutit të Universitetit".

III. Zgjedhja e kryesuesit të përkohshëm të Senatit

Neni 5

- 1) Kryesuesi i përkohshëm i Senatit zgjedhet nga kandidatët e propozuar në Senat me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- 2) Nëse asnjë nga kandidatët e propozuar nuk e merr shumicën e votave, atëherë organizohet radha e dytë e votimit vetëm për kandidatin me numër më të madh të votave. Nëse kandidati nuk e merr shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, në radhën e dytë, konsiderohet se kandidati është refuzuar dhe Senati është i obliguar të propozojë kandidat tjetër.



3) Në rast të votave të barabarta. votimi përsëritet.

IV. Mbledhjet

Neni 6

- 1) Mbledhjet e Senatit i thërret dhe i kryeson rektori i Universitetit (në tekstin e mëtejshëm: kryesuesi).
- 2) Në rast të mungesës së kryesuesit mbledhjen e përgatit dhe e kryeson njëri prej prorektorëve të cilin e cakton Rektori paraprakisht. Nëse edhe prorektorët nuk kanë mundësi të marrin pjesë në mbledhje, mbledhjen e Senatit e kryeson anëtari më i vjetër i Senatit.
- 3) Kryesuesi mbledhjet i thërret sipas nevojës. Gjatë periudhës së rregullt të studimeve, mbledhjet e Senatit mbahen sipas nevojës, por Senati mund të mbajë edhe mbledhje të jashtëzakonshme.
- 4) Kryesuesi është i detyruar të konvokojë mbledhjen e jashtëzakonshme të Senatit nëse atë e kërkon shumica e anëtarëve me të drejtë vote të Senatit, Këshilli Drejtues i Universiteti ose Rektori.
- 5) Anëtarët e Senatit ftohen së paku 2 ditë para mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me fax, e-mail, ose në çfarëdo formë tjetër teknike, me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurt.
- 6) Mbledhjet e senatit në parim janë të hapura për publikun, por jo para se kjo të vendoset në fillim të mbledhjes. Në raste të veçanta Senati mund të organizojë edhe mbledhje të mbyllura për publikun.
- 7) Kryesuesi ka të drejtë në çfarëdo kohe të ftojë ekspertë, ose të ftojë persona të tjerë në mbledhje.
- 8) Kryesuesi është i obliguar të thërrasë mbledhjen e Senatit nëse këtë e kërkojnë më shumë se gjysma e anëtarëve të Senatit dhe nëse qëllimi është i arsyetuar me shkrim. Nëse kryesuesi i Senatit nuk i përgjigjet kërkesës, Senati e informon me shkrim KD-në.

V. Pjesëmarrja në mbledhje dhe përfaqësimi

Neni 7

- 1) Të gjithë anëtarët e Senatit kanë të drejtë dhe janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhjet e Senatit.
- 2) Gjatë mbledhjeve të Senatit, anëtarët duhet të votojnë personalisht. Delegimi i votës nuk lejohet.
- 3) Para se të fillojë mbledhja e Senatit anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Senatit mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje anëtari i Senatit duhet ta njoftojë me kohë kryesuesin.
- 4) Mungesa e pjesëmarrjes në kundërshtim më piken 3 të këtij neni do të reflektohet në mëditjen e shumës së parapare për mbledhje të Senatit.

Neni 8

- 1) Për një anëtar të Senatit mund të konsiderohet se ka konflikt interesi, në pajtim me rregullat juridike dhe Statutin e Universitetit, nëse aktiviteti dhe pjesëmarrja e tij në mbledhje bie ndesh me interesin e tij publik, privat, personal, familjar ose me ndonjë interes tjetër.
- 2) Anëtari Senatorë i cili gjendet në konflikt interesi duhet të lëshojë mbledhjen gjatë asaj kohe kur ajo çështje diskutohet.



- 3) Anëtari në konflikt interesi nuk ka të drejtë vote për çështjen përkatëse.

VI. Fillimi i mbledhjes dhe miratimi i rendit të ditës

Neni 9

- 1) Kryesuesi e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen.
- 2) Për përgatitjen e materialeve për mbledhjen e Senatit kujdeset kryesuesi në koordinim me prorektorët dhe sekretarin e përgjithshëm me shërbimet përkatëse.
- 3) Kryesuesi është i obliguar që në rend të ditës t'i përfshijë propozimet e arsyetuara me shkrim të dërguara 72 orë para mbledhjes. Propozimet me shkrim mund të dërgohen personalisht, me fax, me e-mail dhe të nënshkruara nga parashtuesi.
- 4) Në fillim të mbledhjes Kryesuesi konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, hap diskutimin rreth rendit të ditës, konstaton miratimin e rendit të ditës.
- 5) Kryesuesi i jep fjalën diskutuesit, konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit, ndërmerr masa për sigurimin e mbarëvajtjes së punës në mbledhje, konstaton përfundimin e mbledhjes konform me këtë Rregullore.
- 6) Anëtarët e Senatit kanë të drejtë të propozojnë pika për rendin e ditës, duke e arsyetuar propozimin me shkrim dhe së paku një mbledhje përpara dhe më pas ato diskutohen në mbledhjen e radhës.
- 7) Materialet ose kërkesat të cilat bashkëngjiten gjatë mbledhjes mund të miratohen me shumicën absolute të votave.

VII. Ecuria e mbledhjes

Neni 10

- 1) Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
- 2) Raportin dhe arsyetimin për secilën pikë të rendit të ditës e paraqet kryesuesi ose personi i caktuar nga kryesuesi.
- 3) Të gjithë anëtarët e pranishëm të Senatit mund të marrin pjesë në diskutim dhe t'i paraqesin mendimet dhe propozimet e veta lidhur me çështjet për të cilat diskutohet ose vendoset në mbledhje.
- 4) Në mbledhjet e Senatit diskutimet zhvillohen sipas radhës së paraqitur. Askush në mbledhjet e Senatit nuk mund të diskutojë pa e marrë fjalën nga kryesuesi i mbledhjes.
- 5) Për çdo pikë të rendit të ditës pjesëmarrësit mund të diskutojnë më së shumti dy herë.
- 6) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t'i përmbahen temës dhe kohës së arsyeshme për diskutim.
- 7) Kryesuesi është i obliguar të ndërpresë mbledhjen nëse ai vëren që mbledhja ka marrë kahje të padëshirueshme.

Neni 11

Senati në bazë të propozimit të kryesuesit mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

Neni 12 - Kërkesat dhe ankesat

- 1) Çdo anëtar i Senatit ka të drejtë të parashtrojë kërkesë - ankesë për temën e caktuar.
- 2) Kryesuesi ka të drejtë të kërkojë që kërkesa - ankesa të parashtrohet me shkrim.
- 3) Kërkesat - ankesat për rregullat procedurale duhet të arsyetohen shkurtimisht dhe me

shkrim.

VIII. Vendosja - votimi dhe zgjedhjet

Neni 13

- 1) Për vendimet e rëndësishë së veçantë, si: Propozimi për ndryshim të statutit, miratimin e programeve të reja studimore, miratimin e rregulloreve të Universitetit, Senati i Universitetit vendosë plotfuqishëm vetëm kur në mbledhje janë të pranishëm së paku 2/3 e numrit të përgjithshëm të anëtarëve.
- 2) Para se të votohet, kryesuesi e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës.
- 3) Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Senati merr vendim ose konkluzion.
- 4) Senati vendimet i merr me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm.
- 5) Nëse ka më shumë propozime të vendimeve ose të konkluzioneve, së pari votohet për ato në material ose propozimet nga organet e Universitetit, pastaj për propozimet tjera.
- 6) Votimi bëhet i hapur ose me vota të fshehta. Se si do të bëhet votimi, Senati vendos në mbledhjen përkatëse.
- 7) Votimi bëhet: "për", "kundër", dhe "abstenim".
- 8) Në rast të numrit të votave të barabarta, vota e kryesuesit të Senatit e përcakton votimin.

Neni 14

- 1) Procedurën e votimit të fshehtë e zbaton komisioni i emëruar nga Senati i përbërë prej 3 anëtarëve.
- 2) Pas votimit, në bazë të rezultateve të votimit, kryesuesi, përkatësisht kryetari i komisionit, konstaton se propozimi i vendimit ose i konkluzionit është miratuar ose është refuzuar.

Neni 15

- 1) Votimi me vota të fshehta bëhet për:
 - a) Propozimin e kandidatëve për rektor;
 - b) Zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Drejtues;
 - c) Zgjedhjen e dekanëve;
 - d) Për zgjedhjen e kryesuesit të përkohshëm të Senatit;
 - e) Çështjet që kanë lidhje me interesat e ndonjërit nga anëtarët e Senatit;
 - f) Çështjet kur kryesuesi kërkon për votim të fshehtë.
- 2) Numërimi i votave për këto çështje bëhet nën mbikëqyrjen e Komisionit të Senatit.

IX. Përcaktimi i listës përfundimtare për rektor

Neni 16

- 1) Përcaktimi i listës kandiduese për kandidatë për pozitën e rektorit që do të zgjedhet nga Këshilli Drejtues, bëhet sipas raportit të Komisionit Profesional për zbatimin e zgjedhjeve për rektor, i zgjedhur nga Senati. Komisioni përbëhet prej: katër anëtarë profesorë dhe një anëtar student. Komisioni ka për detyrë të konstatojë se kandidatët e paraqitur për rektor janë të kualifikuar dhe i plotësojnë kushtet formalo-juridike të

- parapara me konkurs dhe me Statut.
- 2) Komisioni Profesional i Senatit vendosë me shumicë të thjeshtë të votave për përcaktimin e listës së kandidatëve për rektor që do t'i dërgohet Këshillit Drejtues.
 - 3) Lista e kandidatëve për rektorë, do të përcaktohet me votim të fshehtë me anë të fletëvotimeve.
 - 4) Në rast se në listën e propozuar për rektor janë më shumë se pesë kandidatë, secili anëtar i Komisionit Profesional duhet të rumbullakojë deri në pesë kandidatë në fletëvotim.
 - 5) Në rast se pesë ose më pak se pesë kandidatë janë në listën e propozuar për rektor, të gjithë kandidatët që i plotësojnë kriteret sipas komisionit evidentohen në listën e propozuar për rektor.

X. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit Drejtues

Neni 17

- 1) Çdo anëtar i Senatit ka të drejtë të bëjë propozime për kandidatë për anëtarë të Këshillit Drejtues të Universitetit.
- 2) Propozimet për kandidatë duhet të jenë të arsyetuara mirë dhe të përfshijnë edhe një biografi të shkurtër për kandidatin.
- 3) Zgjedhja e kandidatëve bëhet me dy votime të njëpasnjëshme.
- 4) Nominimi i kandidatëve për Këshill Drejtues në radhën e parë të votimit bëhet me shumicën relative (që nënkupton mbi 50% të numrit të anëtarëve të pranishëm) dhe bëhet me votim të hapur për secilin kandidat veç e veç,
- 5) Në vazhdim, votimi do të bëhet për të gjithë kandidatët që nuk kualifikohen në radhën e parë. Zgjedhja duhet të bëhet me vota të fshehta me fletëvotime sipas alfabetit. Secili anëtar i Senatit duhet të rumbullakojë deri në katër (4) kandidatë në fletëvotim. Fletëvotimet me më shumë se katër (4) kandidatë konsiderohen të pavlefshme. Nëse edhe pas votimit të dytë dhe të tretë nuk arrihet që të plotësohet lista prej katër kandidatëve të zgjedhur me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, bëhet edhe votimi i katërt. Lista e anëtarëve të Këshillit Drejtues plotësohet me kandidatë që kanë marrë më së shumti vota në radhën e katërt të votimit.
- 6) Senati i Universitetit në çdo kohë mundë ta shkarkojë dhe zëvendësojë për mandatin e mbetur anëtarin e KD-së, nga radhët e Senatit sipas të njëjtës procedurë të këtij neni, nëse i njëjti/a, nuk i përfaqëson denjësisht interesat e Universitetit.
- 7) Në rast të numrit të barabartë të votave, një votim vendimtar do të bëhet për anëtarët me numër të barabartë votash. Kandidatët me shumicë relative votash, sipas rregullave të parapara më lartë do të zgjidhen si anëtarë të Këshillit Drejtues.

XI. Zgjedhja e dekanëve

Neni 18

- 1) Dekanët zgjedhen me vota të fshehta dhe me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve nga lista prioritare e propozuar nga fakulteti.
- 2) Nëse asnjë kandidatë nuk merr shumicën e votave (që nënkupton 50% të numrit të anëtarëve të pranishëm) në radhën e parë të votimit, përsëritet votimi për kandidatin me më së shumti vota. Nëse kandidati nuk e fiton shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve as në radhën e dytë, ai konsiderohet i refuzuar dhe fakulteti është i obliguar që të propozojë kandidat tjetër,

- 3) Në rast të votimeve të barabarta, votimi përsëritet.

XII. Mbajtja e rendit në mbledhje

Neni 19

- 1) Për mbajtjen e rendit në mbledhje kujdeset kryesuesi i mbledhjes.
- 2) Kryesuesi dhe pjesëmarrësit në mbledhjen e Senatit janë të obliguar që t'i përmbahen kësaj rregulloreje.
- 3) Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa:
 - Vërejtje
 - Marrja e fjalës dhe
 - Largimi nga mbledhja.

Neni 20

- 1) Vërejtje me gojë dhe Marrja e fjalës i shqipton kryesuesi ndaj një anëtari të Senatit nëse ky me sjelljen dhe me diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
- 2) Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse edhe pasi t'i merret fjala pengon mirëvajtjen e mbledhjes.
- 3) Largimin nga mbledhja e shqipton Senati me shumicë votash. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

- Procesverbali nga mbledhja e Senatit

Neni 21

Në çdo mbledhje të Senatit mbahet procesverbal. Procesverbalin e nënshkruajnë kryesuesi dhe procesmbajtësi.

- 1) Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
 - a) vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe të mbarimit të mbledhjes,
 - b) rendin e ditës,
 - c) listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë.
 - d) të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse,
 - e) shënimet thelbësore për rrjedhën e mbledhjes,
- 2) Procesverbalit duhet t'i bashkëngjiten edhe dokumentet shtesë
- 3) Pas i mbledhjes së Senatit duhet të përgatitet Procesverbali dhe brenda një jave duhet tu dërgohet si ekstrakt anëtarëve të Senatit.
- 4) Procesverbali miratohet në mbledhjen e radhës të Senatit.
- 5) Procesverbali ruhet në arkiv të Universitetit, me materialet e shqyrtuara sipas pikave të rendit të ditës, si dokumente afatgjata.

XIV. Aktet e Senatit

Neni 23

- 1) Senati nxjerr:
- 2) Rregullore,
 - Vendime,
 - Konkluzione,
 - Rekomandime.
- 1) Senati jep interpretim autentik të akteve që i miraton.
- 2) Procesmbajtësi është i obliguar t'i përgatitë vendimet, konkluzionet dhe



rekomandimet nga mbledhja e Senatit, ndërsa rregulloret i përgatitë komisioni përkatës.

Neni 24

Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejnë për të gjithë anëtarët e Senatit dhe për persona tjerë të ftuar ose të angazhuar në procedurat e Senatit.

Senati i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, do të publikojë të gjitha vendimet të cilat konsideron së janë në interes të publikut.

Neni 25

Për të gjitha çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këtë Rregullore do të zbatohen dispozitat e Statutit dhe të Ligjit për Arsimin e Lartë.

XV. Dispozitat përfundimtare


Neni 26

- 1) Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregulloreje kujdeset kryesuesi i Senatit.
- 2) Interpretimin autentik të kësaj Rregulloreje e jep Senati.
- 3) Rregullorja hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati i Universitetit.


Neni 27

Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhen sipas së njëjtës procedurë të miratimit, dhe më rastin e miratimit të kësaj rregullore shfuqizohet rregullorja nr.649 dt.10.05.2014.

Pejë : 29.02.2021



Prof .Dr. Fadil Millaku


Rektor i Universitetit " Haxhi Zeka" - Pejë